

ENGJULLI YNË



DEMOKRACIA

ATY KU TRAJTOHEMI NË MËNYRË TË BARABARTË

SARANDA (12), DIART (11), EGZON (11)



A keni menduar ndonjëherë se pse ju keni shumë të drejta dhe pse trajtoheni në mënyrë të barabartë?

Kjo qasje e barabartë ndaj juve, filloi të lulëzonte që nga shfaqja e sistemit më të mirë të qeverisjes, që është i njohur si demokraci. Demokracia si sistem i qeverisjes, fillet e para i ka pasur në Athinë, në kryeqytetin e sotëm të Greqisë. Që nga ajo kohë, filloi të vihet në pah fryma demokratike, e cila i dha ngjyrë

jetën tonë të përditshme. Duke filluar nga fakti se ne jemi pjesë e një shkolle pak më larg qytetit të Prishtinës, por trajtohemi në mënyrë të barabartë me nxënësit e të gjitha shkollave të tjera. Përveç që respektojmë njëri-tjetrin, ne kemi lirinë dhe të drejtën të shprehim çdo mendim që duket i arsyeshëm nga ana jonë. E përmendëm arsyen, sepse e dijmë që shprehja e lirë nuk nënkupton të shprehurit prej të cilit mund të fyhet personi tjetër. Ajo nënkupton të shprehurit në mënyrë të duhur duke e ruajtur gjithmonë dinjitetin dhe mirëqenien e secilit njeri. Këtë mund ta lidhim edhe me rëndësinë e respektit ndaj vetes. Personat të cilët respektojnë veten e tyre, pa dyshim që do të respektojnë dhe të tjerët, sepse ata e dinë vlerën e të qenurit i respektuar.

Andaj qytetarë të dashur të shtetit tim, veproni në përputhshmëri me vlerat demokratike, sepse kështu sigurohet e ardhme e sigurt edhe për gjeneratat e tjera.



Liria, element kyç i demokracisë

dhe pozitivitetet jetës së gjithë qytetarëve të shteteve demokratike.

Demokracia si sistemi më i mirë i qeverisjes brenda vetes ngërthen elemente të fuqishme që me zbatimin e tyre, përveç se rritet niveli i këtij sistemi, përmirësohet edhe jeta e vetë qytetarëve. Këto elemente për të cilat po flasim janë: barazia, respekti, toleranca, solidariteti, liria e shprehjes, etj.

Zbatimin e këtyre elementeve e gjejmë shpesh në



Punojmë me shumë përkushtim

KUVENDI DHE LIGJET

ERMIRA (14), JETMIR (15), ERION (12)

Unë jam Andi. Dua t'iu tregoj se Kuvendi ndikon në jetën tonë si qytetarë



Unë jam Elioni. A e dini se si është e mundur që Kuvendi të ndikoj tek ne?




Ndërsa, unë jam Flutura. Kuvendi ndikon në jetën tonë përmes ligjeve që miraton



Më poshtë janë paraqitur disa informata rreth Kuvendit të Kosovës dhe rëndësisë që ka ky institucion

Sot jemi gazetarë të Kuvendit të Kosovës. Përpos që jemi gazetarë, këtu në Punëtorinë „Demos-ti“ u kënaqëm shumë, por dhe mësuam shumë.

Që në minutat e parë kur arritëm në Punëtori, na treguan se do të kemi edhe një vizitë në Kuvendin e Ko-



sovës. Kjo na lumturoi pamasë. Kuvendi nuk ndodhet larg nga zyret e organizatës TOKA. Pasi ta përfundojmë këtë artikull, ne pjesëtarët e grupit tonë, së bashku me dy grupet e tjera, do të shkojmë për vizitë në Kuvend. Mirëpo, për të shkuar deri aty, duhet të kalojmë rrugën. E ne si qytetarë të mirë që jemi, e respektojmë ligjin. Ligji për komunikacionin thotë se vendi i duhur i këmbësorëve për të kaluar rrugën, njihet me emrin „zebra“. Kjo nënkupton se ne do ta kalojmë rrugën pikërisht tek „zebra“, apo vendkalimi për këmbësor.

Kështu duhet të veproni edhe ju. Jo vetëm që duhet ta respektoni ligjin e komunikacionit, por të gjitha ligjet që janë miratuar. E vendi ku miratohen ligjet njihet si „Shtëpia e Popullit“ dhe është pikërisht Kuvendi i Kosovës. Ky funksion i Kuvendit njihet si funksioni legjislativ. Kjo është arsyeja pse jeta jonë ndikohet nga Kuvendi. Pra, përmes ligjeve që miraton, Kuvendi ndikon dhe i jep kahje jetës sonë. Shumë nga ne të cilët jemi nën moshën 16 vjeçare, kemi dëshirë të kemi letërnjoftim. Megjithatë, ne duhet të presim deri në moshën 16 vjeçare për ta marrë letërnjoftimin. Kjo sepse ligji thotë kështu.


Dy funksionet e tjera të Kuvendit janë: funksioni kontrollues, sepse kontrollon punën e Qeverisë; si dhe funksioni përfaqësues, sepse 120 deputetët e Kuvendit të Kosovës, na përfaqësojnë neve. Faleminderit që e lexuat artikullin tonë. Mos harroni të jeni sa më demokratikë.



Gazetarët e artikullit



Demokracia është thesari ynë më i çmuar. Ajo na bën të lutmtur dhe na jep shumë të drejta. Mirëpo, nuk duhet të harrojmë se diçka që e kemi të çmuar, duhet ta ruajmë dhe të punojmë për të



Elementet e demokracisë janë shtylla më e fortë për një jetë sa më të mirë. Prandaj, qytetarë të Kosovës, le të jetojmë në bazë të këtyre elementeve që të jemi demokratikë



Këtu jemi para Kuvendit të Kosovës. Me shumë kënaqësi mësuam për këtë institucion dhe kuptuam rëndësinë që ka në jetën tonë

SOT ZGJODHËM TË JEMI TË LUMTUR

LIRIDONA (14), ALBAN (14)


Çdo ditë, përballemi me diçka të re, diçka që nuk e kemi njohur më parë. Sot ne votuam që lumturinë ta kemi në mesin tonë

Çdo njeri është i veçantë dhe secili prej tyre i ka specifikat dhe preferencat e veta për diçka të caktuar. Ashtu edhe unë si nxënës i klasës së VII-të, kam dëshira të ndryshme nga bashkëmoshatarët e mi. Unë e dua shumë futbollin dhe gjatë kohës së lirë, luaj me shoqët e shoqet e shkollës sonë. Për dallim prej meje, shoqja ime Liridona, e pëlqen shumë volejbollin. Kjo tregon shumë, sepse të gjithë nuk mund ta duam të njëjtën gjë.

Sikurse për zgjedhjet e përditshmërisë sonë që zgjedhim vetë, ashtu edhe për zgjedhjet lokale e qendrore ne individualisht zgjedhim se kujt do t'ia japim votën. Në zgjedhjet lokale, qytetarët e komunave votojnë për kryetarin e komunës së tyre dhe asamblistët.

Ndërsa, në zgjedhjet qendrore, qytetarët e gjithë Kosovës, votojnë për deputetët, si përfaqësues të shtetit, të cilët punojnë në Kuvend. Të gjithë ne gëzojmë të drejtën e votës. Por, së pari duhet ta arrijmë moshën 18 vjeçare, sepse nga kjo moshë konsiderohemi të rritur. Pa dyshim se në këtë moshë do të jemi edhe më të pjekur për ta marrë një vendim të fillë.

Ne do të votojmë, sepse nga votat tona, varet e ardhmja e shtetit tonë.



Edhe pse jemi të ndryshëm, ne bashkëpunojmë me të tjerët



Gazetarët e rinjë



Njerëz të ndryshëm me preferenca të ndryshme



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Dëshmorët e 1921“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VI, VII, VIII & IX
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prapashticë, Prishtinë